



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 1 Regj. Themeltar
Nr. 1 Vendimi**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:

Medi BICI	Kryesues
Sokol BINAJ	Anëtar
Sandër SIMONI	Anëtar

në datën 29.07.2022, mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, çështjen penale nr. 01 akti, që i përket palëve:

KËRKUES: Kurt Rusi

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit të çështjes penale nr. 3247 akti, datë 13.01.2020, që është në shqyrtim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 399/1, 399/2, 399/5, 399/6, 399/7 pika 2 të Kodit Procedurës Civile dhe neni 6/1 i Konventës Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.

Në çështjen penale:

KËRKUES: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë

OBJEKTI: Pushimin e procedimit penal nr. 958, datë 29.01.2019, për veprën penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

KALLËZUES: Kurt Rusi

BAZA LIGJORE: Nenet 328/1/b dhe 329/a të K.Pr.Penale.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Medi Bici dhe bisedoi çështjen në tërësi, në përfundim;

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes:

1. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore ka rezultuar se, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4009 akti, datë 11.12.2019 ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës. Pushimin e çështjes penale nr. 4009 regj. themeltar, datë regjistrimi 08.08.2019, që i përket procedimit penal nr. 958, datë regjistrimi 29.01.2019 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, etj.....*

2. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë nga pala kallëzuese Kurt Rusi.

3. Rezulton se çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë me datë 13.01.2020, me nr. 3247 regjistri. Aktualisht mbi bazën e rishortimit të datës 12.05.2022, çështja i ka kaluar për gjykim gjyqtarit Fatri Islamaj.

4. Për shkak të kalimit të afatit 15 ditor të gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, kërkuesi, në datë 30.05.2022, i është drejtuar Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave për gjykimin e çështjes nga Gjykata e Apelit Tiranë.

5. Në informacionin e parashtruar nga gjyqtari relator i çështjes Fatri Islamaj, është paraqitur shkaku i mosplanifikimit për gjykim të çështjes. Gjyqtari relator ka deklaruar se situata e ngarkesës në punë për sa i përket numrit të çështjeve të prapambetura dhe numrit të ulët të gjyqtarëve që janë aktualisht në detyrë pranë kësaj gjykate është jo e zakonshme. Për këtë arsye, kjo situatë ka ndikuar që në disa raste të bëjë objektivisht të pamundur respektimin e afateve optimale të gjykimit. Për shkak të situatës së krijuar, në datë 04.09.2020, me vendim të Këshillit të Gjykatës së Apelit Tiranë, është vendosur shkrirja e seksioneve (civile dhe penale) dhe e gjithë trupa do të shqyrtonte çështje civile, penale, masa sigurimi, duke iu dhënë prioritet çështjeve penale me të arrestuar, ndërsa çështjet e tjera, përfshirë këtu edhe ato me afate procedurale të përcaktuara në ligj, janë marrë për shqyrtim sipas radhës së regjistrimit nga më i vjetri. Gjithashtu, relatori i çështjes ka bërë me dije se, duke iu referuar kategorisë së kësaj çështje dhe afateve të ngutshme të gjykimit sipas nenit 329 të K.Pr.Penale, është planifikuar në mënyrë të përsheptuar, pra jashtë radhe, për tu zhvilluar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për në datë 13.07.2022, ora 12:30.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë:

6. Kolegji Penal (në vijim Kolegji) konstaton se kërkesa është paraqitur nga një subjekt i cili legjitimohet. Pala kërkuese rezulton të jetë me cilësinë e kallëzuesit në procesin penal për të cilin kërkohet konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm.

7. Kolegji vlerëson se kërkesa është në kompetencën e tij, sipas nenit 399/6, pika 1, shkronja “b” të Kodit Procedurës Civile, pasi përmes saj kërkohet konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes nga Gjykata e Apelit Tiranë.

8. Kërkesa është në kompetencën e Kolegjit Penal, sipas nenit 399/6, pika 1, shkronja “b” të Kodit Procedurës Civile, pasi përmes saj kërkohet konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes nga Gjykata e Apelit Tiranë. Kërkesa i plotëson elementët e parashikuar në nenin 399/5, pika 1 të Kodit Procedurës Civile, si dhe është e shoqëruar me të gjitha aktet e tjera të nevojshme, të përcaktuara në nenin 399/5, pika 2 të Kodit Procedurës Civile.

9. Kolegji vlerëson se parimi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm ka një rëndësi themelore për gjykimin, pasi përbën dhe një nga komponentët e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Ky parim bazohet në postulatit “*drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar*”. Shkalla e respektimit të këtij parimi përcakton në mënyrë të ndjeshme dhe efektivitetin e procesit gjyqësor. (*Shih vendimin H. kundër Francës, datë 24.10.1989 të GJEDNJ*)

10. Kolegji çmon të theksojë praktikën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), e cila ka përcaktuar se periudha e afatit të arsyeshëm për përfundimin e një procesi gjyqësor civil shtrihet, që nga momenti i ngritjes së padisë deri tek momenti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor. (*shih vendimin Qufaj kundër Shqipërisë; Vendimin Scopelliti kundër Italisë, datë 23.11.1993 të GJEDNJ*). Gjykata ka një pozitë kryesore dhe të veçantë, pasi është i vetmi organ që është përgjegjës për dhënien e drejtësisë dhe si e tillë merr pjesë në mënyrë të detyrueshme në të gjitha marrëdhëniet që krijohen gjatë gjykimit të çështjes.

11. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ) në jurisprudencën së saj, ka identifikuar disa elemente përbërëse të këtij standardi. Sipas kësaj jurisprudence në përlllogaritjen e afatit të arsyeshëm merren në konsideratë faktorë të ndryshëm si kompleksiteti i çështjes; sjellja e palëve ndërgjyqëse; sjellja e autoriteteve gjyqësore dhe administrative. (*Shih vendimin Buchholz kundër Republikës Federale Gjermane datë 06.05.1981 dhe Bjeliç kundër Sllovenisë ap. nr. 50719\06, datë 18.10.2012 të GJEDNJ*)

12. Kolegji vlerëson se për sa i përket kompleksitetit të çështjes, ky kriter vlerësimi merr parasysh të gjithë faktorët dhe elementet që kanë të bëjnë me çështjen, natyrën e interesave të përfshira në të, rëndësinë e fakteve, rëndësinë e zgjidhjes ligjore, numri i personave të akuzuar dhe i dëshmitarëve, elementet ndërkombëtarë, lidhja e çështjes me çështje të tjera dhe ndërhyrja e personave të tjerë në procedurë. (*Shih vendimin Trggiani kundër Italisë datë 19.02.1991; Manieri kundër Italisë datë 27.02.1992, Stefancic kundër Sllovenisë, datë 25.10.2012 të GJEDNJ*).

13. Për sa i përket sjelljes së kërkuesit, ky kriter lidhet me mënyrën se si janë sjellë palët në proces ndaj procedimit. Diligjencën e treguar prej tyre për përfundimin e procesit, pengesat që ato kanë krijuar dhe faktorë të tjerë që janë të lidhur me veprimet ose mosveprimet e tyre që kanë ndikuar në ecurinë e procesit. Megjithatë, kjo duhet vlerësuar rast pas rasti vlerëson gjykata, pasi një person nuk është i detyruar të bashkëpunojë me autoritetet proceduese në mënyrë aktive për të përshpejtuar procedurat gjyqësore që çojnë në dënimin e tij. (*shih vendimin Eckkle kundër Republikës Federale Gjermane, datë 15.07.1982 të GJEDNJ*)

14. Nga ana tjetër, Kolegji sjell në vëmendje se, për sa i përket sjelljes së autoriteteve për vlerësimin e kohëzgjatjes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, GJEDNJ ka vlerësuar se vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të merren parasysh. Këto vonesa mund të shkaktohen ose nga autoritetet gjyqësore ose nga autoritetet administrative. Shkaqe të kësaj natyre në jurisprudencën e GJEDNJ janë vënë në dukje p.sh. bashkimi i gabuar i disa çështjeve që ka shkaktuar vonesa të panevojshme, shtyrjet e pabazuara në ligj të seancave gjyqësore, pezullimi i kundërligjshëm i procesit gjyqësor, vonesat nga ana e agjencive publike ligjzbatuese të shtetit në dorëzimin e provave të kërkuara nga gjykata, transferimi i çështjeve penale nga një gjykatë në tjetrën, mbajtja e seancave të apelimeve. (*Shih vendimin Ewing kundër Mbretërisë së Bashkuar*).

15. Në nenin 399/7, pika 3 të Kodit Procedurës Civile, parashikohet se “*Në rast se gjatë shqyrtimit të kërkesës organi që po kryen veprimet, ndërmer hapat që po kërkohen nga pala, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, pushon shqyrtimi i kërkesës*”.

16. Kolegji konstaton se, gjatë kohës që kërkuesi Kurt Rusi ka paraqitur kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave të gjykimit të çështjes penale pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, relatori i çështjes për të cilën kërkohet konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm, ka planifikuar zhvillimin e seancës për shqyrtimin e çështjes, për në datën 13.07.2022, ora 12:30. Me shkresën nr. 4837 prot, datë 28.07.2022, Gjykata e Apelit Tiranë, konfirmon faktin se gjykimi pranë Gjykatës së Apelit Tiranë ka përfunduar, ku me vendimin nr. 693, datë 13.07.2022, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: *“Lënie në fuqi të vendimit nr. 4009 akti, datë 11.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”*. Për sa më sipër, Kolegji konkludon se çështja ka mbetur pa objekt dhe për rrjedhojë duhet të vendoset pushimi i gjykimit të saj.

17. Mbështetur sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se, gjykimi i çështjes nr. 01 akti, datë 14.07.2022 regjistrimi, me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave të gjykimit të çështjes penale pranë Gjykatës së Apelit Tiranë duhet të pushohet në Gjykatën e Lartë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë bazuar në nenin 399/7, pika 3 të Kodit Procedurës Civile;

V E N D O S I

Pushimin e gjykimit të çështjes nr. 01 akti, datë 14.07.2022 rregjistrimi, në Gjykatën e Lartë.

Tiranë, më datë 29.07.2022